

## Порамнување

## Член 266-в

(1) За прекршоците утврдени во членовите 264 и 265 од овој закон, државниот инспектор за труд е должен на сторителот на прекршокот, пред да поднесе барање за прекршочна постапка да му предложи постапка за порамнување, согласно со овој или друг закон и Законот за прекршоците.

(2) Кога сторителот на прекршокот е согласен за поведување на постапка за порамнување, државниот инспектор за труд составува записник во кој се забележуваат битните елементи на прекршокот, времето, местото и начинот на сторување на прекршокот, описот на дејствието на прекршокот, лицата затекнати на самото место и издавањето на платен налог за плаќање на изречената глоба.

(3) Записникот и платниот налог ги потпишуваат државниот инспектор за труд и сторителот на прекршокот. Со потписот на приемот на платниот налог се смета дека сторителот се согласува да ја плати глобата, во рок од осум дена од денот на приемот на платниот налог, на сметка на органот назначен во платниот налог.

(4) Кога како сторител на прекршок се јавува правно лице, записникот и платниот налог го потпишува одговорното лице, односно лицето кое се нашло на лице место при инспекцискиот надзор или друго службено или одговорно лице кое изјавило дека има право да го потпише записникот и да го прими платниот налог.

(5) Сторителот кој ќе ја плати глобата во рокот од ставот (3) на овој член, ќе плати само половина од изречената глоба.

(6) Ако сторителот не ја плати глобата во рокот од ставот (3) на овој член, државниот инспектор за труд ќе поднесе барање за поведување прекршочна постапка до прекршочниот орган.

## Посредување

## Член 266-г

(1) За прекршоците од членовите 264 и 265 на овој закон, државниот инспектор за труд на сторителот на прекршокот ќе му предложи постапка за посредување и постигнување согласност со која сторителот на прекршокот се обврзува да ја плати глобата, другите давачки и да ги отстрани последиците од прекршокот.

(2) Државниот инспектор на труд за случаите од ставот (1) на овој член составува записник во кој се констатира согласноста на двете страни за покренување на постапка за посредување на кој се потпишува и сторителот на прекршокот.

(3) Записникот од ставот (2) на овој член и барање за поведување постапка за посредување, државниот инспектор на труд во рок од три дена доставува до Комисијата за посредување.

(4) Постапката за посредување, врз основа на записник и трошковник се води пред Комисија за посредување формирана од министерот надлежен за работите од областа на трудот.

(5) Комисијата за посредување е составена од претседател и два члена од редот на државните службеници вработени во органот на државната управа надлежен за работите од областа на трудот. Претседателот на комисијата е дипломиран правник со положен правосуден испит.

(6) Претседателот на Комисијата за посредување е должен да ја започне постапката на комисијата во рок од 48 часа од денот кога е пристигнато барањето од ставот (3) на овој член.

(7) Комисијата работи на седница на која задолжително присуствуваат претставници на сторителот на прекршокот и државниот инспектор за труд.

(8) За склучената согласност со посредување се составува спогодба во која се констатира согласноста на двете страни.

(9) Во спогодбата се утврдуваат обврските на сторителот на прекршокот, а особено:

- висината и начинот на плаќање на глобата,
- висината и начинот на плаќање на другите давачки и трошоци и
- мерките кои треба да ги преземе сторителот со цел да се отстранат последиците од прекршокот.

(10) Во случаите во кои е постигната согласност со посредување, глобата на сторителот може да биде намалена за една половина од пропишаната глоба за прекршокот.

(11) Министерот надлежен за работите од областа на трудот донесува деловник и трошковник за работа на Комисијата за посредување.

(12) Членовите на Комисијата за посредување имаат право на награда за својата работа во комисијата што ја определува Министерот надлежен за работите од областа на трудот.

(13) Ако постапката за посредување не успее, Комисијата за посредување го известува државниот инспектор за труд да поднесе барање за поведување прекршочна постапка пред прекршочниот орган.

(14) Комисијата за посредување е должна да води евиденција за поведените постапки за посредување и за нивниот исход.“

## ПРЕОДНИ ОДРЕДБИ

## Член 12

Се овластува Законодавно - правната комисија да утврди пречистен текст на Законот за работните односи.

## Член 13

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

## L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E  
LIGJIT PËR MARRËDHËNIE PUNE

## Neni 1

Në Ligjin për marrëdhënie pune (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/2005 dhe 106/2008), në nenin 67 paragrafi (2) pika 1 në fillim para fjalës ”paguan” i shtohet fjala “neto”, ndërsa në pikën 3 fjala “i rregullt” shlyhet.

## Neni 2

Në nenin 84 fjalët: ”në vend të anulimit të kontratës për punësim” dhe presja para tyre shlyhen, ndërsa para fjalës “paga” i shtohet fjala “neto”.

## Neni 3

Në nenin 97 paragrafi (1) në pikën 1 para fjalës “pagë” shtohet fjala “neto”, ndërsa në pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6 para fjalës “pagat” shtohet fjala “neto”.

Në paragrafin (2) para fjalës “paga” shtohet fjala “neto”, ndërsa fjalët: “paga në bazë të së cilës paguhen kontributet për sigurim social dhe shëndetësor”, zëvendësohet me fjalët: “50% nga rroga mesatare neto e paguar për punëtor në Republikë në muajin e fundit para pezullimit”.

## Neni 4

Në nenin 113 para paragrafit të parë i shtohet numri “(1)”, para paragrafit 2 shtohet numri “(2)”, ndërsa para paragrafit 3 shtohet numri “(3)”.

Në paragrafin (1) pikat 1 dhe 2 shlyhen, ndërsa pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7 bëhen pika 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Në paragrafin (3) pas fjalës “me” shtohen fjalët: “ligj dhe”.

Pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5) si vijon:

“(4) Punëdhënësi, me shpenzimet e veta punëtorëve mund t’u organizojë transport deri dhe prej vendit të punës, si dhe ushqim gjatë kohës së punës.

(5) Shpenzimet për ushqim për paragrafin 4 të këtij neni mund të paraqesin më së shumti deri në 20% nga rroga mesatare neto për punëtor e paguar në vitin paraprak, ndërsa shpenzimet për transport në lartësinë e shpenzimeve reale në komunikacionin publik”.

#### Neni 5

Në titullin para nenit 241 dhe në nenin 241 para fjalës “pagë” shtohet fjala “neto”.

#### Neni 6

Në nenin 259 në paragrafin (1) pika 5 pas fjalëve: “nuk mban” shtohen fjalët: “mban në mënyrë të parregullt ose keqpërdor”.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Ndalesa e paragrafit (1) pika 1) të këtij neni zgjat 30 ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit, për pikat 2, 3 dhe 5 deri në eliminimin e parregullsive, ndërsa për pikën 4 shtatë ditë”.

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“(4) Nëse punëdhënësi i përsërit parregullsitë nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni, do t’i shqiptohet masa ndalim për kryerjen e veprimtarisë prej një deri në pesë vjet.”

Paragrafët (4) dhe (5) zëvendësohen me paragraf të ri (4) si vijon:

“(4) Fletëparaqitje për ngritjen e procedurës gjyqësore në rastin e paragrafit (3) të këtij neni parashtrohet inspektori i punës”.

#### Neni 7

Neni 263 ndryshohet si vijon:

“(1) Kundër aktvendimit të inspektorit të punës nga nenet 258, 259 dhe 262 të këtij ligji mund t’i parashtrohet ankesë ministrit kompetent për punët nga sfera e punës, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(2) Ankesa kundër aktvendimit nga neni 259 nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit”.

#### Neni 8

Në nenin 264, paragrafi (1) numri “8.000” zëvendësohet me numrin “15.000”, në paragrafin (2) numri “5.000” me numrin “10.000”, ndërsa në paragrafin (3) numri “1.000” zëvendësohet me numrin “7.000”.

#### Neni 9

Në nenin 266 shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

“(2) Organ kompetent për shqiptimin e sanksioneve për kundërvajtje sipas paragrafit (1) nga ky nen kompetent është gjyqi përkatës.”

#### Neni 10

Neni 266-a ndryshohet si vijon:

“Organi për kundërvajtje”

#### Neni 266-a

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 264 dhe 265 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban edhe sanksion për kundërvajtje, shqipton organi i administratës shtetërore përgjegjës për punët nga sfera e punës (në tekstin e mëtejme:

organi për kundërvajtje).

(2) Procedurën për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni para organit për kundërvajtje e mban Komisioni për vendosje për kundërvajtjen (në tekstin e mëtejme:

Komisioni për kundërvajtje).

(3) Komisioni për kundërvajtje vendos për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë ligj ose ligj tjetër dhe shqipton sanksione për kundërvajtje të përcaktuara në këtë ligj ose ligj tjetër.

(4) Kundër vendimit për kundërvajtje të cilën e marrë organi për kundërvajtje mund të parashtrohet ankesë për ngritjen e kontestit administrativ”.

#### Neni 11

Pas nenit 266-a shtohen tre nene të reja 266-b, 266-v dhe 266-g si vijon:

“Formimi dhe puna e komisionit për kundërvajtje

#### Neni 266-b

(1) Komisionin për kundërvajtje e formon ministri kompetent për punët nga sfera e punës. Ministri mund të formojë më tepër komisione për kundërvajtje, të cilat do jenë kompetente për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje për sfera të veçanta ose për rajone të veçanta të Republikës së Maqedonisë.

(2) Komisioni për kundërvajtje përbëhet prej kryetarit dhe dy anëtarëve nga radhët e nëpunësve shtetërorë të punësuar në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës. Kryetari i komisionit është jurist i diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudence.

(3) Komisioni për kundërvajtje zgjidhet në kohëzgjatje prej tre vjetësh me të drejtë të rrizgjedhjeve së anëtarëve.

(4) Kryetari dhe anëtar i Komisionit për kundërvajtje mund të shkarkohet:

1) me kalimin e afatit për të cilin është emëruar anëtar;

2) me kërkesën e tij;

3) me plotësimin e kushteve për pensionin e moshës në pajtim me ligjin;

4) nëse është dënuar me aktgjykim gjyqësor të plotfuqishëm për vepër penale;

5) nëse i verifikohet paaftësia e përhershme;

6) nëse verifikohet shkelja e dispozitave për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje me vendim të plotfuqishëm;

7) nëse nuk i plotëson obligimet të cilat dalin nga puna në komisionin për kundërvajtje;

8) nëse nuk ka lajmëruar ekzistimin e konfliktit të interesave për rastin për të cilin vendos komisioni për kundërvajtje.

(5) Komisioni për kundërvajtje ka të drejtë të nxjerrë dëshmi dhe të mbledhë të dhëna që janë të domosdoshme për verifikimin e kundërvajtjes, si dhe të kryejë punë tjera dhe të ndërmarrë veprime të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtjet ose me ligj tjetër.

(6) Anëtarët e Komisionit për kundërvajtje janë të mëvetësishëm dhe të pavarur në punën e komisionit për kundërvajtje dhe vendosin në bazë të njohurive të tyre profesionale dhe bindjes vetjake.

(7) Komisioni për kundërvajtje punon në mbledhje, ndërsa vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(8) Anëtarët e komisionit kanë të drejtë shpërblimi për punën e tyre në komisionin për kundërvajtje të cilin e cakton ministri kompetent për punët në sferën e punës.

(9) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës miraton Rregulloren dhe listën e shpenzimeve për punën e komisionit për kundërvajtje.

(10) Komisioni për kundërvajtje mban evidencën e vetme të kundërvajtjeve, sanksioneve të shqiptuara dhe vendimeve të marra në mënyrë të përcaktuar nga ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

#### BARAZIMI

#### Neni 266-v

(1) Për kundërvajtjet e verifikuara në nenet 264 dhe 265 të këtij ligji, inspektori shtetëror i punës është i obliguar që kryerësit të kundërvajtjes, para se të

parashtrojë kërkesë për procedurë për kundërvajtje t'i propozojë procedurë për barazim, në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër dhe me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Kur kryerësi i kundërvajtjes pajtohet për ngritjen e procedurës për barazim, inspektori shtetëror i punës përgatit procesverbal në të cilin shënohen elementet qenësore të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes, personat e ndodhur në vendngjarje dhe dhënia e urdhërpagesës për pagesën e gjobës së shqiptuar.

(3) Procesverbalin dhe urdhërpagesën i nënshkruajnë inspektori shtetëror i punës dhe kryerësi i kundërvajtjes. Me nënshkrimin e pranimit të urdhërpagesës konsiderohet se kryerësi pajtohet ta paguajë gjobën, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të urdhërpagesës, në llogari të organit të caktuar në urdhërpagesë.

(4) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën e nënshkruan personi përgjegjës, gjegjësisht personi i cili ka ndodhur në vendngjarje gjatë mbikëqyrjes inspektuese ose person tjetër zyrtar ose person përgjegjës, i cili ka deklaruar se ka të drejtë ta nënshkruajë procesverbalin dhe ta pranojë urdhërpagesën.

(5) Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afatin e paragrafit (3) të këtij neni, do ta paguajë vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar.

(6) Nëse kryerësi nuk e paguan gjobën në afatin nga paragrafi (3) të këtij neni, inspektori shtetëror i punës do t'i paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje organit për kundërvajtje.

#### Ndërmjetësimi

##### Neni 266-g

(1) Për kundërvajtjet nga nenet 264 dhe 265 të këtij ligji, inspektori shtetëror i punës kryerësit të kundërvajtjes do t'i propozojë procedurë për ndërmjetësim dhe arritjen e pëlqimit me të cilin kryerësi i kundërvajtjes obligohet ta paguajë gjobën, detyrimet tjera dhe t'i eliminojë pasojat nga kundërvajtja.

(2) Inspektori shtetëror i punës për rastet nga paragrafi (1) të këtij neni përpilon procesverbal në të cilin do të konstatohet pëlqim i të dyja palëve për ngritjen e procedurës për ndërmjetësim në të cilin nënshkruhet edhe kryerësi i kundërvajtjes.

(3) Procesverbalin nga paragrafi (2) i këtij neni dhe kërkesën për ngritjen e procedurës për ndërmjetësim, inspektori shtetëror i punës në afat prej tri ditësh ia dorëzon komisionit për ndërmjetësim.

(4) Procedura për ndërmjetësim, në bazë të procesverbalit dhe listës së shpenzimeve mbahet para komisionit për ndërmjetësim të formuar nga ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(5) Komisioni për ndërmjetësim përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë nga radhët e nëpunësve shtetërorë të punësuar në organin e administratës shtetërore për punët nga sfera e punës. Kryetari i Komisionit është jurist i diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudence.

(6) Kryetari i komisionit për ndërmjetësim është i obliguar ta fillojë procedurën e komisionit në afat prej 48 orësh nga dita e arritjes së kërkesës nga paragrafi (3) të këtij neni.

(7) Komisioni punon në mbledhje në të cilën është e domosdoshme pjesëmarrja e përfaqësuesve të kryerësit të kundërvajtjes dhe inspektorit të punës.

(8) Për pajtimin e kontraktuar me ndërmjetësim përpilohet marrëveshje në të cilën konstatohet pajtueshmëria nga të dy palët.

(9) Në marrëveshje përcaktohen obligimet e kryerësit të kundërvajtjes, e sidomos:

- lartësia dhe mënyra e pagesës së gjobës;
- lartësia dhe mënyra e pagesës së detyrimeve dhe shpenzimeve të tjera;

- masat të cilat duhet t'i ndërmarrë kryerësi me qëllim të evitimit të pasojave e nga kundërvajtja.

(10) Në rastet në të cilat është arritur pajtueshmëri me ndërmjetësim, gjoba e kryerësit mund të zvogëlohet për gjysmën e gjoba së përcaktuar për kundërvajtjen.

(11) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës miraton rregulloren dhe listën e shpenzimeve për punën e komisionit për ndërmjetësim.

(12) Anëtarët e komisionit për ndërmjetësim kanë të drejtë për shpërbllim për punën e tyre në komision të cilin e përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(13) Nëse procedura për ndërmjetësim nuk ka sukses, komisioni për ndërmjetësim e informon inspektorin shtetëror për punë që të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para organit për kundërvajtje.

(14) Komisioni për ndërmjetësim është i obliguar të mbajë evidencë për procedurat e ngritura për ndërmjetësim dhe për përfundimin e tyre."

#### DISPOZITAT KALIMTARE

##### Neni 12

Autorizohet Komisioni juridiko-ligjdhënës të verifikojë tekstin e spastruar të Ligjit për marrëdhënie pune.

##### Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

#### 3315.

Врз основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

#### У К А З

### ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПЕНЗИСКОТО И ИНВАЛИДСКОТО ОСИГУРУВАЊЕ

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за пензиското и инвалидското осигурување,

што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 22 декември 2008 година.

Бр. 07-5648/1  
22 декември 2008 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
**Бранко Црвенковски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
**Трајко Вељаноски, с.р.**

#### ЗАКОН

### ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПЕНЗИСКОТО И ИНВАЛИДСКОТО ОСИГУРУВАЊЕ

##### Член 1

Во Законот за пензиското и инвалидското осигурување ("Службен весник на Република Македонија" број 80/93, 3/94, 14/95, 71/96, 32/97, 24/2000, 96/2000, 50/2001, 85/2003, 50/2004, 4/2005, 84/2005, 101/2005, 70/2006 и 153/2007), во членот 11, став 1 точката 7 се менува и гласи: